LIGJ
Nr. 98/2026

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË FORCËS NDËRKOMBËTARE TË STABILITETIT NË GAZA

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Forcës Ndërkombëtare të Stabilitetit në Gaza.

Neni 2

Numri maksimal i personelit që do të marrë pjesë në këtë operacion do të jetë 40 (dyzet) vetë.

Neni 3

Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Forcës Ndërkombëtare të Stabilitetit në Gaza do të jetë mbështetja e operacioneve të sigurisë dhe stabilitetit, mbrojtja e personelit, objekteve dhe infrastrukturës së misionit, mbështetja e operacioneve humanitare, monitorimi dhe raportimi i situatës së sigurisë, si dhe detyra të tjera në përputhje me mandatin e misionit në kuadër të Bordit të Paqes.

Neni 4

Ushtarakët pjesëmarrës në operacionin ushtarak të Forcës Ndërkombëtare të Stabilitetit në Gaza, përveç pagës mujore, përfitojnë dieta për ditët e qëndrimit në operacion në masën që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.9.2026.

Shpallur me dekretin nr. 508, datë 2.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj